

B.E.K.O.J. (java 1 nga 6)

Mirë se erdhe. Sot fillojmë një seri të re në kishën tonë, uroj që do jetë inkurajim për ty dhe uroj që do na ndjekësh javë pas jave. Gëzohem që kjo kishë është bërë kishë për shumë persona.

Misioni i Jezusit

Seria që fillojmë quhet B.E.K.O.J., çdo javë do të fokusohemi në një nga shkronjat e kësaj fjale dhe do e ilustruam me një histori nga jeta e Jezusit dhe gradualisht do të shikojmë që secili prej nesh ka një mision të dhënë nga Jezusi në jetën e tij. Kur ti zgjedh Perëndinë, Ai e bekon jetën tënde, por nuk mbaron aty, Ai do që pastaj të bekojë të tjerët nëpërmjet teje.

Mund të them me plot bindje që kjo është një nga seritë më të rëndësishme të këtij viti në kishën tonë.

Si fillim, hajde bëjmë muhabet, çfarë janë disa punë, disa gjëra që duhet të bësh patjetër nesër? Që duhen bërë! Ndoshta duhet të jesh diku nesër. Duhet të shkosh në shkollë, punë, duhet të takosh filanin patjetër, duhet të shkosh te dentisti, doktori. Shumë gjëra që presin për ty nesër ose gjatë javës.

CS Lewis, një nga mendimtarët më të mëdhenj të shekullit të shkuar tha një gjë të bukur për vrullin e jetës së përditshme.

C. S. Lewis: *“Cdo mëngjes kur zgjohesh, të gjitha dëshirat dhe synimet e ditës të lëshohen me vrull si kafshë të egra.”*

Vuuu, dhe për shumicën prej nesh nuk janë dëshira dhe synime më shumë sesa gjërat e rutinës së përditshme.

Gjërat e përditshme nuk është se kanë ndonjë pasion të madh brenda, se janë gjëra që duhen bërë dhe janë të njëjtat gjëra.

Njërit, që i kishte ardhur në majë të hundës rutina e përditshme, tha:

“Booo, më është mërëzitur jeta, çohem çdo ditë në të njëjtën orë, fik çdo mëngjes të njëjtin alarm, shkoj çdo mëngjes te e njëjta banjo, shikoj të njëjtën fytyrë në pasqyrë, bëj të njëjtin dush, përdor të njëjtin peshqir, vesh të njëjtat xhinse. Shkoj dhe ulem te e njëjta kuzhinë, ha të njëjtin mëngjes, marr të njëjtën çantë për të dalë nga shtëpia, puth të njëjtën grua. Pse, çka donte ky, një grua të ndryshme çdo ditë?!”

Pastaj marr të njëjtin autobus, është i njëjti fatorino, që i tregoj të njëjtën abone, ndaloj në të njëjtin stacion, shkoj te e njëjta punë, qesh me të njëjtat shaka pakuptim që thotë shefi, ha drekë në të njëjtin vend.

Puna mbaron në të njëjtën orë, pastaj marr të njëjtin autobus për shtëpi, përqafoj të njëjtët femijë, ulem te e njëjta kuzhinë dhe ha të njëjtën darkë.

Pastaj ulem tek i njëjti divan, shikoj të njëjtat telenovela, më zë gjumi në të njëjtin divan, pastaj mezi shkoj nëpër gjumë te i njëjti krevat, bëj të njëjtat

muhabete me gruan, pastaj kthehem nga i njëjti krah i imi, vë të njëjtin alarm dhe nesër Fillon e Njëjta Gjë.”

Ka shumë njerëz që i vë para rutina e jetës. Mua më lodh jeta e njëlojtë, po ty? Më lodh jeta pa qëllim, pa motivim, pa pasion, rutina. Se robi një jetë ka! Dua të zgjohem plot qëllim dhe dëshirë për të bërë diçka të re dhe të them, ‘Po Sikur’, pa frikën nëse bëhet ose jo.

Tashti, sigurisht që ka ca gjëra që **duhen bërë**. Por ka dhe ca gjëra të tjera që nuk duhen bërë. Por mos harro, Perëndia të ka krijuar dhe kur të krijoi, vuri brenda teje një ëndërr, një synim, një gjë që vetëm ti e ke. Një thënie e bukur: Frederick Beuchner: “*Thirrja jonë gjendet aty ku pasioni i madh takohet me nevojën më të madhe.*”

Unë besoj që misioni yt gjendet diku mes pasionit tënd dhe nevojave që janë përreth teje. Në 5 javët e ardhshme, shpresa ime është që çdo person ta gjejë, ta zbulojë misionin e tij aq qartë saqë ta kuptojë dhe të thotë: Unë duhet ta bëj patjetër këtë gjë!

Dua të përmend një histori shumë të njohur nga Bibla ku Jezusi duhet të bënte diçka. Ndoshta nuk të ka tërhequr vëmendjen fillimi i kësaj historie më parë, por ja si thuhet:

Por (Jezusi) duhej të kalonte nëpër Samari... . Gjoni 4:4

Këtë mund ta lexosh në dy mënyra:

1. ose sikur të ishte e zorshme, s’kishte çfarë të bënte, duhej të kalonte aty;
2. ose DUHET të kalonte aty, sepse aty do të ndodhte diçka. Kishte një arsyë, diçka brenda Tij thërriste: Unë **duhet** të kaloj andej.

Nëse të kujtohet konteksti, ose po ta shikosh pak me vëmendje, judenjtë e evitonin rrugën që binte nga Samaria gjithmonë. Samaritanët ishin të urryer nga judenjtë, ishin armiq për ta. Samaritanët ishin për judenjtë si tifozët e Partizanit para tifozëve të Tiranës në ndonjë ndeshje finale, që nuk kalojnë nga ana e njëri-tjetrit.

Kur Bibla thotë që Jezusi DUHEJ të kalonte nëpër Samari, ajo që e bën të veçantë këtë fjali është se Jezusi nuk duhet të shkante askund, Ai zgjidhte vetë se ku të shkante. Ai mund të kishte zgjedhur rrugën tradicionale. Por Jezusi duhet të shkante nëpër Samari për shkak të misionit që kishte nga Perëndia, sepse aty ishte një grua që ai duhet ta takonte.

Jezusi takon te pusi këtë gruan samaritane, ajo erdhi për të mbushur ujë në kohën kur nuk vinte njeri për të mbushur ujë. Ajo po u fshihej të tjerëve, që të mos kishte kontakt me njerëzit e qytetit fare, sepse ajo kishte qenë martuar 5 herë dhe ndërkohë po bashkëjetonte me mashkullin numër 6 me të cilin nuk ishte e martuar. Ose ngaqë kishte reputacion të dyshimtë, ose për shkak të gjithë këtyre martesave të dështuara, lagjja nuk e donte. Ose mund të ishin të dyja shkaqet bashkë.

Dhe për shkak të saj, Jezusi tha: “Unë duhet të shkoj atje ku nuk ka shkuar askush.” Ai ishte në një mision të qartë: Ai po shkonte për të restauruar jetën e saj. Jezusi nuk e vrau mendjen që ajo ishte samaritane. As që ajo kishte reputacion të dyshimtë. As që komuniteti nuk e donte atë grua.

Dhe Jezusi, jo vetëm që foli me të, por e trajtoi me dinjitet duke i dhënë vëmendje dhe kujdes. Kjo gjë i ndryshoi jetën asaj. Ajo, nga një grua që shkonte të mbushte ujë në piskun e vapës që të mos e shikonte njeri, u kthye në një grua që, pasi përjetoi dashurinë pa kushte të Jezusit, shkoi në qytetin e saj dhe u tregoi të gjithëve përjetimin jetë-ndryshues që kishte patur me Jezusin. Bibla madje thotë që e la enën e ujit, stambën e ujit, shkoi në qytet dhe u tha të gjithëve:...

Ejani të shikoni një njeri që më ka thënë gjithçka kam bërë; vallë mos është ky Krishti? Gjoni 4:29

Pse është e veçantë kjo histori? Sepse kjo histori nxjerr në pah disa gjëra të rëndësishme.

Së pari, kuptojmë që Jezusi ishte në një mision. Për Jezusin kjo çështje ishte aq e rëndësishme saqë tha: “Unë duhet të shkoj atje.”

Së dyti, kuptojmë që edhe ne kemi një mision. Si ndjekës të Jezusit ne kuptojmë qartë se misioni i Jezusit është edhe misioni ynë. Ne duhet t’u qepemi pas çështjeve të rëndësishme siç do të bënte vetë Jezusi, sepse **duhet**.

Së treti, kur e kuptojmë atë që duhet bërë, i qepemi pas dhe nuk heqim dorë.

(shënim për pastorin:

opsionale:

Kjo seri do jetë me life-story të ndryshme (të lidhura drejtpërdrejt me mesazhin), dua të ftoj persona që do të ndajnë momente nga jeta e tyre në lidhje me:

Si e gjetën, kuptuan cili ishte qëllimi i Perëndisë për jetët e tyre;

Atë që këta persona besojnë se ishte misioni i Jezusit për ta.

Life-story, djali/vajza.

Kush është ky djali/vajza, e njihni?

Djali/vajza, kur dëgjove për Jezusin?

Si ishte ecja jote me Zotin, a ka qenë vaj apo ka patur ulje-ngritje?

Kur vendose që do t’i shërbeje Zotit. A beson që ky është misioni yt? Pse?

Mirënjohës Perëndisë për një dajlë/vajzë kaq pasionant dhe të papërtuar për të bërë çdo gjë që është e mundur për të fituar një më shumë për Jezusin.)

Gruaja te pusi i Samarisë kishte interes për të ditur më shumë për Perëndinë. Kur dikush nuk e gjen rrugën për te Perëndia, mundohet ta mbushë boshllëkun me gjëra të ndryshme.

Çdo ditë ti dhe unë hasim persona të tillë. I ke te puna, te lagjja, te shkolla, te familja. Janë njerëz si ty dhe si unë, që kanë boshllëqet që kishe ti edhe unë. Janë njerëz që janë akoma larg Perëndisë. Jezusi do që ne të shkojmë tek ata, misioni i Tij duhet të na çojë të shkojmë tek ata.

Kur dikush njih Jezusin dhe përjeton dashurinë e Perëndisë, ai lidhet, miqësohet me Perëndinë dhe me ne.

Gruaja samaritane kishte njerëz që thoshin se e donin atë, madje gjithë burrat e fshatit ashtu thoshin, por ishte mënyrë për të abuzuar me të dhe për shkak të zgjedhjeve që ajo kishte bërë, ëndrra e Perëndisë për jetën e saj ishte e fashitur, megjulluar.

Ka njerëz plot rreth e qark nesh, që për shkak të zgjedhjeve të tyre po jetojnë jetët sikur Perëndia nuk ekziston fare. Ose për shkak të padrejtësive që u janë bërë, janë të mbyllur edhe kur u flet për Perëndinë.

Por Perëndia do që të të përdorë ty për tu dhënë dashuri të sinqertë, për t'ia zgjatur dorën, për tu bërë zë për ata që s'kanë zë. Ky është misioni ynë: t'i sjellim njerëzit te Perëndia që ta njohin dhe përjetojnë dashurinë pa kushte të tij. Kur dikush e merr dhe përjeton dashurinë e Perëndisë, ai shkon dhe ua tregon të tjerëve. Ja se çfarë bëri gruaja nga Samaria edhe pse ajo ishte e përjashtuar nga komuniteti, pasi ka përjetuar dashurinë pa kushte të Jezusit: ajo e merr dhe e përcjell misionin e saj te komuniteti ku jetonte.

Dhe shumë samitanë nga ai qytet besuan në të, për shkak të fjalës së gruas që dëshmoi: Ai më tregoi gjithçka kam bërë. Gjoni 4:39

Ajo nuk po mendon më 'Ja sa të shkojë ora 12 e drekës, që të shkoj të mbush ujë.' Jo, ajo tani thotë: "Unë duhet t'u tregoj të gjithëve për Jezusin."

Ti e realizon misionin që të ka dhënë Perëndia duke bërë diçka aty ku je, duke bërë diçka që ka lidhje me kishën tonë ose jashtë kishës, duke dhënë dashuri dhe kujdes në forma të ndryshme.

Po të themelohemi, të stabilizohemi në vetvete së pari, në dashurinë e Perëndisë, të rrënjosemi vetë së pari, pastaj natyrshëm kjo dashuri do të reflektohet tek të tjerët përreth nesh. Ngjan ndonjëherë si Hëna, ajo s'ka dritë por reflekton dritën e diellit, edhe ne, nuk mjafton dashuria njerëzore, duhet ajo Hyjnore, ti ngopesh së pari me dashurinë e Perëndisë, pastaj e reflekton atë te njerëzit rreth e qark teje.

Ndoshta sot të duken fjalë të bukura këto, por pa lidhje me realitetin, sepse të ka zënë pesimizmi, të ka zënë virusi që ka zënë 50% të shqiptarëve, që ky vend nuk bëhet, ky vend është shkretëtirë, është thatësirë e madhe, rrëmujë, çfarë ndihme do të sillte kontributi im në këtë qytet, vend?

A e ke menduar ndonjëherë - s'ka gjë, mos e ngri dorën - ndoshta ngjan me këtë videon që do të shikojmë tani: Në një ishull në Indi, njerëzit po iknin sepse ishte bërë vend i shkretë, nuk kishte shpresë. Por një njeri nuk iku, dhe filloi të mbillte fara dhe fidanë cdo ditë, derisa ai ishull u kthye në një pyll të bukur.

Video, burri që mbolli pemë cdo ditë. :

<https://www.youtube.com/watch?v=LbGKWa8G-2s>

Në dukje është një gjë shumë e vogël, por aq duhet nëse rregullisht çdo njeri nga ne mbjell fara dhe fidanë të vegjël dashurie. Kujdesi rreth e qark “ishullit”, pra vendit ku jemi, një ditë do të japë fryte.

Unë mendoj dhe besoj shumë që deri në fund të këtij viti çdo person në këtë kishë do të ketë një histori misioni për të treguar. Jam i sigurt për këtë. Kisha jonë është kishë që do të sjellë influencë pozitive në këtë qytet dhe vend. E bukura është kjo: nuk do të themi në përgjithësi që kisha jonë është kishë që do të sjellë ndikim, influencë, sepse ka kuptuar misionin e Jezusit dhe po e zbaton atë. Jo, jo, unë dua dhe besoj që ky mision do të jetë specifik për çdo person në kishën tonë. Nëse ke zgjedhur t’i besosh Jezu Krishtit si Zot dhe Shpëtimtar, ne duam që ti personalisht të jesh në misionin që Jezusi ka vendosur ose do të vendosë në zemrën tënde.

Dua që nga sot të bëjmë fiks siç bëri Jezusi. Nuk do të gjesh në Bibël që ndjekësit e Jezusit ndaheshin në kategori, pjesërisht të përkushtuar dhe plotësisht të përkushtuar.

Jo, jo, në momentin që zgjodhën t’i besojnë Jezusit dhe u pagëzuan, ata ishin gati për ta ndjekur dhe bërë atë që Perëndia donte nga ata që të bënin.

Nëse ti je ndjekës i Jezu Krishtit, ti ke një mision!

Puna ime, puna e çdo drejtuesi në grupet e vogla, shërbesat e kishës, është të të ndihmojmë ty në zbulimin e këtij misioni.

Disa prej jush kanë për të zbuluar që misioni juaj është te lagjja juaj. Për disa të tjerë mund të jetë te puna ose te shkolla. Për disa mund të jetë të ndjekë një kauzë në qytetin ose në komunitetin që jeton. Ka shumë gjëra që ti mund të bësh, një nga shenjat kur kuptohet ajo që duhet të bësh është kur diçka të shqetëson shumë dhe duhet të bësh diçka.

(shembull:

Po bisedoja me dikë që ishte shumë po shumë fare i shqetësuar për situatën se çfarë po ndodh me qentë në Tiranë, Zoti i ka ndërtnuar disa njerëz me një pasion dhe dashuri të veçantë për kafshët.

Tashti, akoma është ideja e vjetër e marrë nga komunizmi, ideja e mbijetesës.

Për të mbijetuar duhet të jemi vetë mirë dhe të heqim çdo gjë që na pengon.

Madje kjo është një nga arsyet pse kujdesi për kafshët duket qesharake: “Nuk paske punë tjetër ti, merresh me kafshët, ne s’jemi mirë vete, ti merresh me kafshët!” Këto lloj përgjigjesh, janë cifla të rrënjëve të vjetra të 50 viteve komunizëm, ne mezi po mbijetojmë vetë, ti do që të merresh me kafshët.

Jo, jo, nëse ky është merakut yt, ky mund të jetë misioni yt, kujdesi për kafshët.

Por kjo gjë ka një rrezik të vogël. Njerëzit që kujdesen për kafshët le të

rrezatojnë dashuri dhe kujdes jo vetëm për to, por për njerëzit para. Mos fillo që

nga inati të trajtosh njerëzit si kafshë dhe kafshët si njerëz. Por duke dhënë kujdes për to të rrezatosh dashurinë dhe zemrën e Jezusit në atë gjë.)

Le të jenë këto javë mundësia jonë për të ndërruar syzet, dhe për të vënë syze të reja. Le të mos e shikojmë këtë vend si shkretëtirë, por ta shikojmë me sytë e mundësive. Dakort, nuk ekziston filan gjë? Atëherë, unë kam për të bërë diçka, kjo mund të jetë mundësia ime, përderisa me shqetëson mua dhe nuk më lë rehat, **unë duhet të bëj diçka.**

(opsionale

Deri në fund të këtij viti çdo person në kishën tonë do të ketë një histori misioni për të treguar, e sigurt, jam shumë i sigurt.

Prandaj këto javë, së pari, dua që çdo grup i vogël të marrë këtë libër (Zbulo Misionin Tënd Tani) dhe ta lexojnë, diskutojnë së bashku.

Nëse nuk je në një grup të vogël ose je i ri dhe nuk e di se për çfarë po flas, tako djalin/vajzën në fund të sallës, ose më tako mua, unë do të jem aty gjithashtu.

Para se të ikësh sigurohu që ke folur me të dhe ai/ajo do të të sugjerojë një grup ku mund të bëhesh pjesë. Madje nëse je i ri, për herë të parë në kishën tonë, ata kanë një dhuratë për ty.)

Ndërsa shikojmë momente nga jeta e Jezusit do të zbulojmë hap pas hapi strategjinë e tij sesi vendosi Ai për ta ndikuar dhe ndryshuar gjithë botën.

Një moto të këtij ndryshimi e shikojmë që kur Perëndia i kërkoi Abrahamit për të ndryshuar botën, dhe strategjia që Perëndia përdori ishte strategji bekimi. Ja ta shikojmë:

Unë do të bekoj ... te ti do të jenë të bekuara tërë familjet e tokës. **Zanafilla 12:3**

Këtë strategji bekimi do e çmontojmë javë pas javë në festimet e kishës sonë. Prandaj fjala bekoj është bërë me pika në mes të çdo shkronje,

B.E.K.O.J.

sepse çdo shkronjë përfaqëson një titull mesazhi për 5 javët në vazhdim, përfaqëson një strategji bekimi që do flasim dhe vëmë në zbatim si kishë. Do e lë kështu pezull që të vini me qejf javës tjetër. Por një gjë ju siguroj, në fund të serisë, nëse i vë në zbatim këto 5 hapa, kanë për ta ndryshuar jetën tënde:

Nga: “Duhet të bëj të njëjtat gjëra, s’kam çfarë të bëj.”, të ndryshojë në: “Unë duhet të bëj filan gjë, nuk rri dot më, unë **duhet.**”

Si mbyllje, dua të shikojmë foton e këtij personi. Kush e njeh?

(Foto e Wael Ghonim)

Në vitin 2011 u zgjodh nga Revista Time, si njeriu më influencues në botë. ‘Ouu, prit pak, çfarë bëri ky. Se rob i thjeshtë duket, ngjan me një çun te lagjja ime.’

Ai është nga Egjipti, te ky djalë ndodhi diçka brenda tij kur pa varfërinë, sistemin arsimor, sistemin gjyqësor në vendin e tij dhe tha: “Unë duhet të bëj diçka.” Ai punonte për Google, dhe përdori aftësitë e tij në median sociale, Facebook dhe Twitter, për të folur dhe rekrutuar rininë.

E bukura është kjo: Ishte zëri i një personi të vetëm që më vonë u bë katalizator i një revolucionit që solli fundin e diktaturës dhe fillimin e lirisë për miliona të tjerë në gjithë Egjiptin. Tashti, unë s’kam qenë në Egjipt dhe nuk e di ekzakt sesi janë gjërat tani. Por ajo që më bëri përshtypje ishte se filloi nga një njeri i vetëm, si videoja që pamë më lart, me një njeri që shpëtoi një ishull të tërë.

Sa njerëz duhen për të sjellë revolucion dhe për të ndryshuar një vend? Një, vetëm ti. Kur ti fillon, kur ti shikon diçka dhe thua: ‘Kjo duhet bërë dhe do e filloj unë.’ Ka ndryshime mes:

t’u japësh mend tjerëve në Facebook si të bëjnë gjërat, t’u japësh ide; me:

kur ti çohesh vetë dhe thua: “Kjo duhet bërë dhe do e bëj unë, jo, jo, këtë do e filloj unë.”

Nëse duhej vetëm një djalosh për të sjellë liri një kombi të tërë duke përdorur Facebookun e tij për një mision që e kishte shumë të qartë, imagjino se çfarë mund të bëjmë ne të gjithë bashkë.

Le të themi: “Nuk mjaftohem vetëm me faktin që e di se cili është misioni i Jezusit për jetën time ose misioni i Jezusit për këtë kishë, unë dua, unë do të bëhem pjesë e këtij misioni, Unë Duhet Të Jem Në Mision.”

Nëse të gjithë ju do të bashkoheni me mua, nëse ne do të bashkohemi me Jezusin dhe misionin e tij, ne kemi për të qenë katalizator i një Revolucionit, dhe do jetë Revolucion ndryshe, Revolucion Dashurie dhe Bekimi që do të ndryshojë këtë qytet këtë vend dhe përtej.

A je gati ti?

Le të lutemi

Lutja e Shpëtimit